

Statistikat afatshkurtra

Prodhuësit e të mirave - Tremujori I 2025

Tiranë, më 16 Qershor 2025: Treguesit tremujorë mbi prodhuësit e të mirave, përfshijnë aktivitetet ekonomike: Industri (Industri Nxjerrëse dhe Industri Përpunuese); Energji elektrike, Gaz, Avull; Furnizimi me ujë, Trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve; Ndërtim, në tremujorin e parë 2025, paraqiten si më poshtë:

Industria:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënie 10,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rënie 2,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rënie 4,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 2,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Energji elektrike, Gaz, Avull:


- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënie 2,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rënie 6,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rënie 6,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 3,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Furnizimi me ujë, Trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënie 0,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rënie 1,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 0,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 4,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Ndërtimi:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 7,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rritje 7,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 3,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 16,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum (%)**Tab. 1 Indeksi i shitjeve neto në volum, prodhuesit e të mirave**

NVE Rev.2			Pa përshtatje sezonale		Me përshtatje sezonale	
Seksioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Tr.I 2025 (2021=100)	I.25 / I.24 (%)	Tr.I 2025 (2021=100)	I.25 / IV.24 (%)
B-C	05-33	Industri	79,5	-10,8	84,8	-1,7
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	66,9	-1,5	72,6	2,6
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	82,6	-12,7	87,2	-2,1
D	35	Energji elektrike, Gaz, Avull	74,3	-2,0	65,0	-3,3
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	110,8	-0,9	112,8	1,4
F	41-43	Ndërtim	103,3	7,5	120,5	-1,2
Grupimet industriale kryesore						
		Mallra të ndërmjetme	72,5	-18,9	73,8	-1,2
		Energji	71,5	-5,2	64,9	-2,0
		Mallra kapitale	86,7	-6,7	92,8	-3,3
		Mallra të qëndrueshme konsumi	80,5	5,8	92,0	-2,9
		Mallra të paqëndrueshme konsumi	96,8	4,9	105,1	-1,2

Tab. 2 Indeksi i prodhimit në volum, prodhuesit e të mirave

NVE Rev.2			Pa përshtatje sezonale		Me përshtatje sezonale	
Seksioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Tr.I 2025 (2021=100)	I.25 / I.24 (%)	Tr.I 2025 (2021=100)	I.25 / IV.24 (%)
B-C	05-33	Industri	83,7	-2,1	88,8	-0,4
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	63,3	-2,1	66,4	0,7
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	90,7	-2,0	97,6	-1,3
D	35	Energji elektrike, Gaz, Avull	82,7	-6,1	81,4	-2,8
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	119,3	-1,0	120,1	-0,4
F	41-43	Ndërtim	102,5	7,6	131,3	-1,9
		Grupimet industriale kryesore				
		Mallra të ndërmjetme	79,9	0,6	89,3	-1,4
		Energji	74,6	-9,3	71,6	-0,1
		Mallra kapitale	84,4	-10,8	93,8	-3,7
		Mallra të qëndrueshme konsumi	82,3	7,3	96,0	-1,8
		Mallra të paqëndrueshme konsumi	95,7	1,7	102,2	-1,7

Metodologjia

Qëllimi - Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt. Vrojtimi tremujor ka për qëllim të paraqesë ecurinë e treguesve kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve ekonomike në periudha tremujore.

Në prodhuesit e të mirave:

Fusha e mbulimit - Bazuar në aktivitetin kryesor, në anketën tremujore pranë ndërmarrjeve janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë këto aktivitete:

- Industri, e cila përbëhet nga Industria Nxjerrëse dhe Përpunuese (05 – 33)
- Energji elektrike, gaz, avull (35)
- Furnizimi me ujë, trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve (36-39)
- Ndërtim (41, 42, 43)

Modeli - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku kampioni për ndërmarrjet me 1-9 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht.

Mbledhja e informacionit - Për këtë tremujor janë përdorur burimet administrative dhe intervistim të drejtpërdrejtë nga anketuesit, të cilët plotësojnë anketën tremujore në bazë të deklarimeve që bën personi përgjegjës i ndërmarrjes për plotësimin e kësaj ankete.

Treguesit - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht 2021=100, Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

Indekset - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash, Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres, Për të eliminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatohen me indekset përkatëse të çmimeve, si: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për aktivitetin industrial dhe Tregtinë me Shumicë, Indeksi i Kostos në Ndërtim për aktivitetin ndërtimor.

Ndryshimi vjetor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më parë.

Ndryshimi tremujor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtit vit.

Rishikimi – Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur, etj.

Përkufizimet e treguesve kryesorë

Shitjet neto - *Shitjet neto* përfshijnë shumën e faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësi që vërohet për periudhën referuese dhe kjo korrespondon me tregun e shitjes së mallrave dhe shërbimeve të tretëve, duke përjashtuar taksën mbi vlerën e shtuar.

Indeksi i shitjeve neto - Objektivi i indeksit të *shitjeve neto* është të paraqesë ecurinë e tregut për mallra dhe shërbime.

Numri i të punësuarve me pagesë - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë në njësinë e vrojtuar (përjashtuar të vetëpunësuarit me pagesë).

Paga dhe trajtime - Ajo përfshin fondin e pagave dhe shpërblimet e trajtimet (në vlerë monetare apo natyrë - të vlerësuar në lekë) paguar të gjithë të punësuarve, në këmbim të punës së kryer gjatë periudhës referuese,

Indeksi i fondit të pagave - Indeksi i fondit të pagës paraqet në mënyrë të përafërt ecurinë e fondit të pagave, në njësinë e vërtetuar, nga njëra periudhë në tjetrën.

Grupimet Industriale Kryesore janë një rigrupim i aktiviteteve Industri Nxjerrëse, Industri Përpunuese dhe Energji të detajuara sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev.2), si më poshtë:

Grupimet Industriale Kryesore	NVE Rev.2
Mallra të ndërmjetme	• 07-09 Nxjerrja e mineraleve natyrore; Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat; Aktivitete mbështetëse minerare • 13000 Përpunimi i tekstileve • 16000 Prodhimi i drurit dhe materialeve prej druri, përveç mobiljeve • 17000 Prodhimi i letërës dhe produkteve prej letre • 20-21 Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike; Përpunimi i produkteve farmaceutike • 22000 Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës • 23000 Prodhimi i produkteve minerale jo metalike • 24000 Metalurgjia • 255XX Farkëtimi, stampimi, petëzimi dhe trafilizimi i metaleve • 27000 Prodhimi i pajisjeve elektrike
Energji	• 05-06 Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve; Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror • 19000 Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës • 35000 Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri i kondicionuar
Mallra kapitale	• 251XX Prodhimi i produkteve metalike strukturore • 262XX Prodhimi i kompjuterave dhe pajisjeve periferike • 28000 Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p,k,t • 33000 Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve
Mallra të qëndrueshme konsumi	• 264XX Prodhimi i produkteve elektronike për konsumatorët • 31000 Prodhimi i mobiljeve • 32XXX Industri të tjera p,k,t
Mallra të paqëndrueshme konsumi	• 10000 Përpunimi i produkteve ushqimore • 11-12 Prodhimi i pijeve; Prodhimi i produkteve të duhanit • 14000 Konfeksionimi i veshjeve • 15000 Prodhimi i lëkures dhe produkteve prej lëkure • 18000 Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara • 32YYY Industri të tjera p,k,t

Përshtatja sezonale

Përshtatja sezonale në seritë tremujore të prodhimit të të mirave materiale u zbatua duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2.2.4. Model i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënspecifikimin X-13 në serinë kohore Tremujori I 2006 - Tremujori I 2025. Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizshme. Në seritë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishtë (multiplikative).